**Giovanni Cimbalo** ka lindur në Kozencë (Itali), më 31 gusht 1947. Është Profesor i së Drejtës Kishtare në Universitetin e Bolonjës "Alma Mater Studiorum". Mes botimeve të tij, përmendim: I rapporti finanziati tra Stato e Confessioni religiose nei Paesi Bassi (Milano 1989); La scuola tra servizio pubblico e principio di sussidiarietà: legge sulla parità scolastica e libertà delle scuole private confessionali (Torino 1999); Le Regioni alla ricerca di una identità inesistente. La legislazione regionale tra "differenziazione dell'offerta formativa" e parità scolastica (Torino 2003); Laicità come strumento di educazione alla convivenza, in S. Canestrari, Laicità e diritto, (Bologna 2007); Problemi e modelli di libertà religiosa individuale e collettiva nell' Est Europaa: contributo a un nuovo diritto ecclesiastico per l'Unione Europea. Scritti in onore di Giovanni Barberini (Periugia 2009); Le confraternite islamiche nei Balcani; un modelo di Islam europeo plurale, in "Daimon". Annuario di diritto comparato delle religioni (Bologna 2009); Integrción de los migrantes: un Islam plural para Europa, in Alvares Conde, M.Salazar dela Guerra (eds.). Estudios sobre la integración de los emigrantes (Madrid 2010), Il diritto ecclesiastico oggi: la territorializzazione dei diritti di libertà religiosa, in "Il riformismo legislativo in diritto ecclesiastico e canonico" (Cosenza 2011); L'Africa in miniatura. Prime note su diritto e religione in Camerun, in F.Alicino, F. Botti (a cura di). I diritti culturali e religiosi tra Africa ed Europa (Torino 2011).

Kjo monografi mbi raportet e shtetit shqiptar me fenë, shkruar nga prof. Giovanni Cimbalo, Universiteti i Bolonjës, Itali, sillet në shqip nga botimet "Naimi".

UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPERISE

Naimi

Shtëpi Botuese *dhe* Studio Letrare

GIOVANNI CIMBALO

## Pluralizmi i besimit dhe komunitetet fetare në Shqipëri

Studime të së drejtës së krahasuar.
E DREJTA KISHTARE DHE TË DREJTAT NJERËZORE.
Raporti i fesë me shtetin në Shqipëri.




# *Ftesë*

Z. Znj. ______________________________

Një analizë krahasuese mes normave dhe ligjeve të miratuara prej fillimit të shtetit shqiptar, gjatë monarkisë, regjimit komunist deri më sot e ka lejuar autorin të depërtojë më thellë në historinë e këtij vendi, për të hedhur më shumë dritë mbi ndryshimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve institucionale mes komuniteteve fetare dhe shtetit; të kuptojë ç'ndikim ka pasur kjo në formimin e mendësisë mbi përkatësinë fetare dhe ç'trajtë ka sot ushtrimi dhe pjesëmarrja në jetën fetare.

Nga shqyrtimi i historisë kushtetuese, praktikës juridike e politike që në zanafillë të shtetit të vet, autori vëren se ndër parimet e saj themelore Shqipëria ka ndarjen mes shtetit dhe fesë, laicitetin e institucioneve, e kryesisht, pluralizmin fetar, i parë si formant i rëndësishëm i sistemit ligjor, një prej përbërësve themelorë për ndërtimin e unitetit kombëtar, si vlerë e epërme për vendin.

Ky studim paraqet një aspekt të parë të rendit sistematiko-rindërtues, por edhe metodologjik, sepse prek, si çështjen e klasifikimit të marrëdhënieve mes shtetit dhe komuniteteve fetare, po ashtu edhe qasjen që duhet të ketë studiuesi që në momentin e përballjes me to. Vend të veçantë në këtë studim zë edhe efektshmëria e sistemeve të të tjerëve (në rastin tonë, ai shqiptar), e cila mund të shërbejë për përmirësimin e marrëdhënieve mes grupeve të ndryshme shoqërore dhe fetare, qoftë edhe në procesin e homologimit të këtyre sistemeve, si shprehje e globalizimit dhe e vlerave universale të disa parimeve e sidomos të rregullave për frenimin e qëndrimeve radikale.

Shtëpia botuese "**Naimi**"
në bashkëpunim me
**Akademinë e Shkencave të Shqipërisë,**
**dhe Universitetin Mesdhetar**
**të Shqipërisë (UMSH)**
ditën e shtunë, datë 12 prill 2014,
ora 12.00,
në sallën "Aleks Buda"
në Akademinë e Shkencave, Tiranë,

O R G A N I Z O N

promovimin e librit

**"Pluralizmi i besimit**
**dhe komunitetet fetare**
**në Shqipëri"**

të autorit **Giovanni Cimbalo,**
profesor në Universitetin e Bolonjës.

Në promovim do të jenë, gjithashtu,
të pranishëm, përveç autorit, edhe
profesorët **Francesco Altimari** dhe
**Matteo Mandalà.**

Pjesëmarrja juaj na nderon!